



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 638 prot.

B.Curri me, 31.12.2025

VENDIM

Nr 79 Datë 24.12.2025

PËR SHPËRNDARJEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E VITIT TË PARË TË
ARSIMIT TË MESËM PROFESIONAL NË INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026

Këshilli i Bashkiak Tropojë, me propozimin e kryetarit të bashkisë, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025, në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 24 dhe nenit 54 shkronja “k” dhe nenit 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.69/2012, date 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr.48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” i ndryshuar; Shkresës së Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënës të ndjekin klasen e 10-te në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimorë 2025-2026”, me Nr 973/1 datë 24.10.2025 protokolluar pranë bashkisë Tropojë me nr. 5246 prot., datë 31.10.2025; dhe Relacionit të Komisionit të ngritur nga Bashkia Tropoje me Urdhrin nr. 311, datë 27.10.2025 me Nr. 5106 Prot,

V E N D O S I :

1. Të miratojë listën e nxënëzëve të vitit të parë të shkollave profesionale që përfitojnë bursapër për vitin akademik 2025-2026.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Shpallur me 30.12.2025, Miratuar me 14vota,Vota Pro 14,Vota Kunder 0,Vota Abstenim 0

SEKRETARI
Ergent GJONGEÇAJ

KRYETAR
Arbër ÇAKRAJ

Tabela 1

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Shkolla	Bursa	Kriteri
1	Elisiada Xhafer Zhiva	“Mesme Profesionale” Kamëz	E plote	2.1 (a) Nd .ekonomike
2	Ardjon Aranit Çelaj	“Gjergj Canco”, Tiranë	E plote	2.1 (a) Nd .ekonomike
3	Kristjan Shkelzen Kukaj	“Arben Broci” Shkoder	E plote	2.1 (a) Nd .ekonomike
4	Everest Besnik Muhametaj	“Gjergj Canco”, Tiranë	E plote	2.1 (a) Nd .ekonomike
5	Paulo Pal Vukaj	“Arben Broci” Shkoder	E plote	